




Periodik mujor Nr. 193 Qershor 2025

Në
këtë
periodik
do të lexoni:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
vijon takimet informuese
mbi fondet e pensioneve private
në Shqipëri



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri,
Janar-Maj 2025

ZHVILLIME TË TJERA

3-5

BOTIME PROFESIONALE

6-11

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

12-15

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar – Maj 2025

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar – maj 2025 kapën vlerën 10,075 milionë lekë, ose 7.60% më shumë se në janar – maj 2024. Gjatë periudhës janar – maj 2025, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 609,763 me një rritje prej 9.29% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 90.58% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 9.38% dhe risigurimi me 0.041%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 40.02% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 59.98% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar – maj 2025, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 3,304 milionë lekë, ose 5.59% më pak se në janar – maj 2024.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për janar – maj 2025 kapën vlerën 2,504 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 2.22% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar - maj 2025 arritën rreth 6,043 milionë lekë, ose 13.03% më shumë se në janar – maj 2024.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar - Maj 2025 (Në %)



ZHVILLIME TË TJERA

AMF organizon takim informues mbi Ligjin “Për Fondet e Pensionit Privat” me stafin akademik dhe administrativ të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës



Takimi kishte si qëllim rritjen e njohurive financiare për përfshirjen në skemat e pensionit privat, si një mundësi për të siguruar më shumë të ardhura në moshën e pensionit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në datë 11 qershor 2025 zhvilloi një takim informues mbi risitë që ofron Ligji “Për Fondet e Pensionit Privat” në Republikën e Shqipërisë me stafin akademik dhe administrativ të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Në kuadër të edukimit financiar takimi kishte si qëllim rritjen e njohurive financiare për përfshirjen në skemat e pensionit privat, si një mundësi për të siguruar më shumë të ardhura në moshën e pensionit.

Ekspertët njohën pjesëmarrësit me rolin e Autoritetit si rregullator dhe mbikëqyrës i tregjeve financiare jo bankare, në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorit dhe investitorit.

Pjesë e këtij takimi ishin dhe përfaqësues të Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimit. Në prezantimin e tyre ata u fokusuan konkretisht te veprimtaria e fondeve të pensioneve private në Shqipëri, avantazhet e anëtarësimit në skemën e këtyre fondeve, si për individin ashtu edhe për biznesin.

Prezantimet u ilustruan edhe me shembuj konkretë të përlogaritjes së kontributit të punëmarrësit dhe punëdhënësit në fondin e pensionit privat, duke theksuar risitë dhe lehtësitë fiskale që ofron Ligji i ri nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.

Vijon ...

AMF organizon takim informues mbi Ligjin “Për Fondet e Pensionit Privat” me stafin akademik dhe administrativ të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës

... vijon

Pjesëmarrësit në këtë takim treguan interes të shtuar, veçanërisht në drejtim të përfshirjes së institucionit të tyre në skemat e pensioneve private, si një mjet motivimi për punonjësit.

Autoriteti do të vijojë me aktivitete të tjera, me qëllim rritjen e kulturës financiare, në zbatim të strategjisë për edukim dhe përfshirje financiare.



**IOSCO shpall temat për edicionin e 9-të të Javës
Botërore të Investitorëve që do të mbahet në
6-12 tetor 2025.**

**Ajo do të përqendrohet te Teknologjia dhe Financat
Digjitale, Inteligjenca Artificiale dhe Parandalimi i**



Java Botërore e Investitorëve (WIW) e IOSCO-s është një fushatë globale njëjavore për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e edukimit dhe mbrojtjes së investitorëve, si dhe për të nxjerrë në pah iniciativat e ndryshme të rregullatorëve të letrave me vlerë në këto dy fusha kritike.

Duke filluar më 6 tetor 2025, dhe me mbështetjen e Presidencës së G20, WIW 2025 do të bashkojë organizata nga mbi 100 juridiksione, për të rritur ndërgjegjësimin rreth çështjeve që ndikojnë tek investitorët në të gjithë botën. Temat kryesore përfshijnë:

1. Teknologjia dhe Financat Digjitale - Teknologjitë e reja përdorin algoritme që mund të mos e marrin në konsideratë disa elementë. Tregtimi imitues ose tregtimi fraksional nuk janë zëvendësim për diversifikimin e portofolit dhe përgatitjen për ngjarje të paparashikuara.
2. Inteligjenca Artificiale (IA) - Mjetet e IA-së mund të përmirësojnë shërbimet financiare, por ka shumë rreziqe të lidhura me të cilat investitorët duhet të jenë të vetëdijshëm, duke përfshirë shfrytëzimin e të dhënave personale.
3. Parandalimi i Mashtrimeve - Mashtruesit janë të sofistikuar. Ata shfrytëzojnë në mënyrë aktive trendencat e investitorëve për përfitimin e tyre financiar dhe i joshin investitorët e pafajshëm në mashtrime në forma nga më të ndryshmet.

vijon ...

Informacioni
gjendet në:

www.worldinvestorweek.org

**IOSCO shpall temat për edicionin e 9-të të Javës
Botërore të Investitorëve (WIW) që do të mbahet në
6-12 tetor 2025.**

**WIW 2025 do të përqendrohet në Teknologji dhe
Financa Digjitale, Inteligjencë Artificiale dhe
Parandalimin e Mashtrimeve**



... Vijon

Këto tema përputhen me Udhërrëfyesin e IOSCO-s për Sigurinë Online të Investitorëve me Pakicë dhe do të plotësohen me diskutime dhe aktivitete mbi Kripto Asetet dhe Bazat e Investimit.

Në Javën Botërore të Investitorëve të vitit 2024 u përfshinë 132 subjekte nga 118 juridiksione dhe aktivitetet ndikuan në miliona individë. Aktivitetet shpesh plotësohen në nivel kombëtar nga një gamë e gjerë organizatash të industrisë dhe arsimit, duke përfshirë shkollat dhe universitetet lokale.

Kryetari i Bordit të IOSCO-s, Jean-Paul Servais, njëkohësisht edhe Kryetar i Autoritetit të Shërbimeve dhe Tregjeve Financiare të Belgjikës, tha: "Mbrojtja e Investitorëve është një gur themeli i rëndësishëm i punës së IOSCO-s. Kohët e fundit, Bordi miratoi disa botime që trajtojnë se si teknologjia po ndikon në vendimet e investimeve me pakicë, duke përfshirë këshilla për investitorët online se si të qëndrojnë larg rreziqeve të lidhura. WIW 2025 do të ndihmojë të mbahen në qendër të vëmendjes këto diskutime. Jam mirënjohës për të gjithë anëtarët tanë dhe organizatat partnere për mbështetjen e tyre të vazhdueshme."

Vijon...

Informacioni
gjendet në:
<https://www.iosco.org>

**IOSCO shpall temat për edicionin e 9-të të Javës
Botërore të Investitorëve (WIW) që do të mbahet në
6-12 tetor 2025.**

**WIW 2025 do të përqendrohet në Teknologji dhe
Financa Digjitale, Inteligjencë Artificiale dhe
Parandalimin e Mashtrimeve**



... Vijon

Z. Camille Beaudoin, Drejtor i Edukimit Financiar dhe Partneriteteve për, AMF Quebec, njëkohësisht Kryetar i Komitetit të IOSCO-s që drejton fushatën e këtij viti, shtoi: “Ne ishim të kënaqur që patëm një angazhim kaq të jashtëzakonshëm vitin e kaluar. Synimi dhe larmia e aktiviteteve të ofruara nga anëtarët ishin mbresëlënëse. Përparësia e fushatës sonë WIW është se ajo mund të përshtatet në mënyrë të përkryer për të përmbushur nevojat e juridiksioneve lokale dhe kjo e bën atë të rëndësishme për të gjithë.”

Ashtu si në vitet e kaluara, WIW 2025 do të mbështetet nga një numër organizatash partnere, duke përfshirë “Ditën Botërore të Planifikimit Financiar” të krijuar nga Bordi i Standardeve të Planifikimit Financiar (FPSB) - e cila do të zhvillohet të mërkurën, më 8 tetor - dhe Federata Botërore e Bursave.

Informacioni
gjendet në:

<https://www.iosco.org>

OECD publikon “Perspektiva Ekonomike”, Volume 2025/ no.1



Sipas botimit “Perspektivës Ekonomike” (*Economic Outlook*) të fundit të OECD-së, perspektivat ekonomike globale po dobësohen, me pengesa të konsiderueshme në tregti, kushte më të rrepta financiare, rënie të besimit dhe pasiguri të shtuar të politikave, gjë që parashikohet të kenë ndikime negative në rritje.

Economic Outlook parashikon një ngadalësim të rritjes globale nga 3.3% në vitin 2024 në 2.9% si në vitin 2025, ashtu edhe në vitin 2026. Ngadalësimi pritet të jetë më i përqendruar në Shtetet e Bashkuara, Kanada, Meksikë dhe Kinë, me rregullime më të vogla në rënie në ekonomitë e tjera. Rritja e PBB-së në Shtetet e Bashkuara parashikohet të bjerë nga 2.8% në vitin 2024 në 1.6% në vitin 2025 dhe 1.5% në vitin 2026. Në zonën e euros, rritja parashikohet të forcohet në mënyrë modeste nga 0.8% në vitin 2024 në 1.0% në vitin 2025 dhe 1.2% në vitin 2026. Rritja e Kinës parashikohet të moderohet nga 5.0% në vitin 2024 në 4.7% në vitin 2025 dhe 4.3% në vitin 2026.

Presionet inflacioniste janë rishfaqur në disa ekonomi. Kostot më të larta tregtare në vendet që rrisin tarifatat pritet të nxisin më tej inflacionin, megjithëse ndikimi do të kompensohet pjesërisht nga çmimet më të ulëta të mallrave. Inflacioni vjetor në ekonomitë e G20 pritet të moderohet kolektivisht nga 6.2% në 3.6% në vitin 2025 dhe 3.2% në vitin 2026.

“Ekonomia globale është zhvendosur nga një periudhë rritjeje elastike dhe inflacioni në rënie në një rrugë më të pasigurt”, tha Sekretari i Përgjithshëm i OECD-së, Mathias Cormann. “Perspektiva jonë e fundit ekonomike tregon se pasiguria e politikave të sotme po dobëson tregtinë dhe investimet, po zvogëlon besimin e konsumatorëve dhe bizneseve dhe po frenon perspektivat e rritjes. Qeveritë duhet të angazhohen me njëra-tjetrën për të adresuar çdo çështje në sistemin global tregtar në mënyrë pozitive dhe konstruktive përmes dialogut - duke mbajtur tregjet e hapura dhe duke ruajtur përfitimet ekonomike të tregtisë globale të bazuar në rregulla për konkurrencën, inovacionin, produktivitetin, efikasitetin dhe në fund të fundit rritjen.”

Për raportin e plotë
dhe më shumë
informacion,
konsultohuni me
“Economic Outlook”
në internet.

<https://www.oecd.org/en/topics/economic-outlook.html>

... Vijon

**OECD publikon “Perspektiva Ekonomike”,
Volume 2025/ no.1**



... Vijon

Economic Outlook nxjerr në pah një sërë rreziqesh, duke filluar me shqetësimin se fragmentimi i mëtejshëm i tregtisë, duke përfshirë rritjet e reja të tarifave dhe veprimet hakmarrëse, mund të intensifikojnë ngadalësimin e rritjes dhe të shkaktojnë ndërprerje të konsiderueshme në zinxhirët e furnizimit ndërkufitar. Inflacioni mund të jetë më i vazhdueshëm se sa parashikohej, veçanërisht në ekonomitë që përballen me kosto shumë më të larta tregtare ose me tregje pune të ngushta, duke nxitur politikë monetare më kufizuese dhe duke dobësuar perspektivat e rritjes.

Pagesat më të larta të borxhit mund të rrisin presionin fiskal mbi qeveritë në mbarë botën, ndërsa kushtet më të shtrënguara financiare do të paraqesin rreziqe shtesë për vendet me të ardhura të ulëta. Tregjet e aksioneve janë rikuperuar nga një rënie e kohëve të fundit, por mbeten të paqëndrueshme.

Nga ana pozitive, një përmbysje e barrierave të reja tregtare do të nxiste perspektivat e rritjes globale dhe do të ulte inflacionin. Një zgjidhje paqësore për luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës dhe të konflikteve të vazhdueshme në Lindjen e Mesme mund të përmirësonte gjithashtu besimin dhe stimujt për të investuar.

Bankat qendrore duhet të mbeten vigjilente, duke pasur parasysh pasigurinë e shtuar dhe potencialin që rritjet fillestare të kostove tregtare të nxisin presionet e pagave dhe çmimeve në përgjithësi. Me kusht që pritjet për inflacionin të mbeten të ankoruara mirë dhe tensionet tregtare të mos intensifikohen më tej, uljet e normave të politikës duhet të vazhdojnë në ekonomitë në të cilat inflacioni parashikohet të moderohet dhe rritja e kërkesës agregate është e ulët.

Vijon ...

Për raportin e plotë
dhe më shumë
informacion,
konsultohuni me
“Economic Outlook”
në internet.

<https://www.oecd.org/en/topics/economic-outlook.html>

OECD publikon “Perspektiva Ekonomike”, Volume 2025/ no.1



... Vijon

Përballë presioneve të shumta të shpenzimeve, qeveritë duhet të sigurojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të borxhit dhe të ruajnë aftësinë për të reaguar ndaj goditjeve të ardhshme. Përpyqje më të forta për të përmbajtur dhe rialokuar shpenzimet dhe për të optimizuar të ardhurat, të vendosura brenda shtigjeve të besueshme afatmesme të përshtatjes specifike për vendin, do të jenë të rëndësishme që barrat e borxhit të mbeten të menaxhueshme dhe për të ruajtur hapësirën fiskale të nevojshme për të adresuar sfidat afatgjata të shpenzimeve. Presionet e konsiderueshme mbi tregtinë, pasiguria gjeopolitike dhe perspektivat modeste të rritjes përforcojnë nevojën për reforma ambicioze të politikave strukturore që forcojnë standardet e jetesës dhe nxisin konkurrueshmërinë ekonomike. Një fokus i fortë duhet t'i kushtohet politikave për të rigjallëruar investimet në biznes, inovacionin dhe produktivitetin.

"Investimet kanë qenë në rënie që nga kriza financiare globale dhe kjo ka qenë pengesë për rritjen", tha Kryeekonomisti i OECD-së, Álvaro Santos Pereira. "Investimet më të mëdha në ekonominë dixhitale dhe të bazuar në njohuri janë një zhvillim pozitiv, por investimet publike mbeten të thujse njëjloj dhe investimet në strehim nuk po arrijnë të përballojnë kërkesën. Një axhendë e guximshme reformash politike për të nxitur investimet mund të ndërtojë një ekonomi globale më të fortë për shekullin e 21-të."

Për raportin e plotë
dhe më shumë
informacion,
konsultohuni me
"Economic Outlook"
në internet.

<https://www.oecd.org/en/topics/economic-outlook.html>

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

BOSNJE-HERCEGOVINA

www.xprimm.com

Sipas njoftimeve të agjencisë lokale të sigurimeve, AZOBİH, të Bosnje-Hercegovinës, në fund të marsit 2025, tregu i sigurimeve në vend arriti në 140.8 milionë euro, duke u rritur me 6.14% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit u rrit me 10.3% në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar, duke arritur në 60.11 milionë euro.

Primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 7% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 114.77 milionë euro, ndërsa primet në segmentin e sigurimit të Jetës u rritën me 2.13% në 26 milionë euro. Nga nënklasat e Jo-Jetës, 14.7 milionë euro korrespondojnë me linjat e pronës dhe 73.08 milionë euro me sigurimin motorik (Sigurimi Kasko dhe MTPL, të përmbledhura), të dy segmentet e tregut shënuan një trend paksa negativ.

Vlera e primeve të shkruara bruto të siguruesve që operojnë në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës u rrit me 7.27% në 100 milionë euro (ose 71% e totalit të primeve të shkruara bruto), ndërsa siguruesit me seli në Republikën Serbe të Bosnjës realizuan 40.76 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 3.45% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

ÇEKI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Bankës Kombëtare Çeke, siguruesit çekë e mbyllën tremujorin e parë të vitit 2025 me një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 2.51 miliardë euro, pothuajse 7% më shumë në krahasim me të tremujorin e parë të vitit të kaluar. Dëmet e paguara janë rritur me 4.74%, duke arritur në 1.12 miliardë euro.

Sektori i sigurimeve të Jetës pati një dinamikë pozitive, megjithëse me një ritëm më të ngadaltë se segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës. Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës u rrit me 6.5% në krahasim me të tremujorin e parë 2024, duke arritur në 615 milionë euro. Sigurimi i Jetës i lidhur me skemat e investimeve pati një rënie prej 7.5% të primeve të shkruara bruto, duke arritur në 162.66 milionë euro. Të gjitha linjat e tjera të sigurimit të Jetës regjistruan norma pozitive rritjeje me dy shifra. Dëmet e paguara u rritën në përgjithësi me 3.46%.

Në sektorin e sigurimeve të Jo-Jetës, vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit me 7.12%, duke arritur në 1.89 miliardë euro, një total që përfshin risigurimin e pranuar. Pjesa më e madhe e kësaj shume u sigurua nga linjat e sigurimit të automjeteve, që arritën një vëllim të primeve të shkruara bruto prej rreth 811.3 milionë euro. Sigurimi i pronës është segmenti i dytë më i madh i sigurimit të Jo-Jetës, me prime në vlerë 487.9 milionë euro, dhe rritje prej 10.8%, në terma vjetore.

Dëmet e paguara për sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 5.33%, duke arritur në 774.2 milionë euro, megjithatë, dëmet për sigurimin e automjeteve ende përbëjnë pjesën më të madhe në këtë total. Në të njëjtën kohë, dëmet në sigurimin e pronës u rritën me 18.6%, duke arritur në 149.87 milionë euro.

GREQI

www.xprimm.com

Sipas statistikave paraprake të tremujorit të parë 2025, të publikuara nga HAIC - Shoqata Helenike e Kompanive të Sigurimeve, në fund të marsit, tregu i sigurimeve në Greqi arriti në vlerën e 1.37 miliardë euro, prime të shkruara bruto, ose 2.2% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sipas shifrave të paraqitura, segmenti i sigurimeve të Jetës pati rënien më të fortë, me -11.3% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 612.3 milionë euro prime të shkruara bruto. Pjesa më e madhe e kësaj rënieje në biznes erdhi nga linja "Sigurimi i Jetës i lidhur me fondet e investimit", e cila pësoi rënie prej 16.8% të vlerës së primeve dhe humbi 3 pikë përqindjeje nga pesha e saj në portofolin e tregut. Sigurimet e Jo-Jetës u rritën me rreth 6.5% në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 760.4 milionë euro.

Rezultatet e tregut për tremujorin e parë 2025, të publikuara nga HAIC, përfshijnë shifrat për 47 sigurues, nga të cilët 42 ishin aktivë në sigurimet Jo-Jetës dhe 14 në sigurimet e Jetës. Nga 47 siguruesit që veprojnë në vend, 26 janë themeluar në Greqi, në formën e shoqërisë së sigurimeve S.A., 1 në formën e kooperativës së sigurimeve të përbashkëta, 15 janë si degë të ndërmarrjeve të huaja të sigurimeve dhe 5 shoqëri evropiane të sigurimeve që operojnë nën statusin FOS.

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas statistikave të tremujorit të parë 2025, të publikuara nga Banka Qendrore e Hungarisë, vëllimi i primeve të shkruara bruto të raportuar nga siguruesit hungarezë arriti në 568.96 miliardë HUF, afërsisht 1.41 miliardë euro. Kjo vlerë është 24.22% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, e shprehur në monedhën lokale. Biznesi i sigurimit të Jetës përbënte 40.7%, një peshë dukshëm më e lartë (afërsisht +7 pikë përqindjeje më shumë) në portofolin e tregut krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2024.

Sa i përket dëmeve, totali i dëmeve të shkaktuara (pagesat dhe ndryshimi i rezervave) u rrit me pothuajse 11% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 216.66 miliardë HUF. Dëmet e sigurimeve të Jetës arritën në 121.3 miliardë HUF, ndërsa në sigurimin e Jo-Jetës, dëmet arritën në 95.35 miliardë HUF.

RUMANI

www.xprimm.com

Në tremujorin e parë të këtij viti, siguruesit rumunë paguan mbi 41 milionë RON, rreth 8.2 milionë euro) vlerë të dëmeve për shtëpitë e dëmtuara nga ngjarje të paparashikuara dhe rreziqe të ndryshme. Sipas të dhënave të UNSAR (Shoqata Kombëtare e Kompanive të Sigurimeve dhe Risigurimeve në Rumani), kjo është një rritje e dukshme prej 18% krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2024.

Nga totali, më shumë se 39 milionë RON u paguan sipas policave të sigurimit vullnetar të shtëpisë, duke shënuar një rritje prej 20% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja pasqyron ndërgjegjësimin në rritje midis rumunëve për dobësitë e shtëpive të tyre dhe një gatishmëri në rritje për të mbrojtur investimet e tyre përmes mbulimit me siguracion.

Rumania po preket gjithnjë e më shumë nga ngjarjet ekstreme të motit dhe rreziqe që lidhen me shtëpitë që mund t'i dëmtojnë ndjeshëm ose edhe t'i shkatërrojnë ato. Vitin e kaluar, siguruesit paguan mesatarisht 100 kërkesa në ditë për dëme që lidhen me shtëpitë. Nga këto, rreth 50 kërkesa në ditë lidheshin me dështime në instalimet e brendshme, ndërsa 21 kërkesa lidheshin me dëmtime nga stuhitë.

Pavarësisht këtyre tendencave, niveli i përgjithshëm i mbrojtjes mbetet i ulët. Vetëm 17% e shtëpive rumune janë të siguruara plotësisht - që do të thotë se ato kanë policat e detyrueshme ose vullnetare. Me fjalë të tjera, mbi 80% e shtëpive mbeten të pambrojtura, ose të paktën të nënsiguruara, ndaj kërcënimeve reale që variojnë nga zjarret dhe përmbytjet e deri te ngjarjet e rënda të motit.

Në Rumani, policat vullnetare të sigurimit të shtëpisë mund të blihen vetëm për pronat që mbulohen tashmë nga policat e detyrueshme PAD. Këto policat opsionale ofrojnë mbulim më të gjerë bazuar në vlerën aktuale të ndërtesës dhe/ose përmbajtjes së saj. Ato mund të mbulojnë fatkeqësitë natyrore, dhe rreziqe të tilla si zjarri, shpërthimi, stuhitë, objektet që bien, dëmtimet nga uji nga defektet e hidraulikës, problemet e sistemit të ngrohjes ose ftohjes, madje edhe dëmtimet në elektronikë dhe pajisje.

Në vend ofrohen edhe zgjedhje të personalizuar sigurimi për sende specifike shtëpiake ose edhe për mbrojtje nga përgjegjësia në rast se dëmi u shkaktohet aksidentalisht fqinjëve.

TURQI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë (TSB), vëllimi total i primeve të gjeneruara në tregun e sigurimeve në Turqi u rrit në monedhën vendase me pothuajse 52% gjatë tremujorit të parë 2025, në 304.16 miliardë TRY ose rreth 7.47 miliardë euro. Ritmi i rritjes u ngadalësua në krahasim me periudhën e mëparshme, por mbeti ende shumë i lartë.

E shprehur në monedhën evropiane, si rezultat i zhvlerësimit të lirës turke në raport me euron, shkalla e përgjithshme e rritjes së tregut ishte +30.11%. Vlen gjithashtu të përmendet se rritja e tregut tejkaloi inflacionin, i cili në fillim të vitit 2025 ishte një nga më të ulëtat në kohët e fundit, në rangun 38%-42%.

Primet e sigurimeve të Jo-Jetës në tremujorin e parë 2025 u rritën me 49.5% duke arritur në 266.56 miliardë TRY ose 6.55 miliardë euro. Primet e sigurimit të Jetës u rritën me pothuajse 74.67% në terma vjetorë duke arritur në 37.6 miliardë TRY ose rreth 923.84 milionë euro. Shoqata e Sigurimeve të Turqisë ka në përbërjen e saj 68 anëtarët aktivë.



Për informacion
të mëtejshëm
kontakttoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al